

VENDIM
Nr. 824, datë 28.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 288, DATË 10.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË PROCEDURËS SË DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FOSHNJAT E PORSALINDURA DHE MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 288, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ndihmën e menjëhershme financiare (bonusi) sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, e përfitojnë:

a) prindi/prindërit e foshnjës së porsalindur, shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të paktën 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike të vitit paraardhës, sipas të dhënave të sistemit TTMS dhe të regjistruar sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile.

b) prindi/prindërit me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, të cilëve nga shteti shqiptar u është dhënë statusi i refugjatit, i mbrojtjes plotësuese ose i azilkërkesit dhe vendosin t’i japin foshnjës shtetësi shqiptare, sipas ligjit për shtetësinë shqiptare, dhe e regjistrojnë si shtetas shqiptar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.”.

b) Në kreun III, pas pikës 26 shtohet pika 26/1, me këtë përmbajtje:

“26/1. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura, në çdo rast, prindi/prindërit, krahas dokumentacionit të përcaktuar në këtë vendim, paraqesin edhe formularin e vetëdeklarimit, që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

c) Në fund të vendimit shtohet aneksi nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Aneks nr. 1

FORMULAR I VETËDEKLARIMIT

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Emër Mbiemër	
Atësia/ Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jetoj pa ndërprerje në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Shërbimi Social Shtetëror autorizohet të verifikojë të dhënat e sistemit TIMS për vitin paraardhës, lëshuar nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, që vërteton se 180 ditë kalendarike, kam qenë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër Mbiemër/firmë

Emër Mbiemër/firmë